

## Fletë informuese 1:

### Kundërshtimi i komunitetit për hidrocentralin e financuar nga BERZH-i në Tërnovë

<b>Përshkrimi</b>	<p>Në vitin 2012 BERZH-i miratoi një financim prej 6 milion EUR për ndërtimin e hidrocentralit të Tërnovës prej 8.3 MW. Skema e projektit, devijon rrjedhën e ujit nga katër liqene malore që kanë shërbyer për qëllime vaditje dhe si burim për ujë të pijshëm, për fshatrat vendore. Komuniteti mësoi për projektin e planifikuar vetëm kur kompania solli makineritë dhe filloi pastrimin e pyllit në vitin 2013-të. Kompania Teodor 2003 shpk, nuk ishte konsultuar me banorët përpara fillimit të punimeve, pavarësisht se skema e hidrocentralit e kufizonte aksesin e banorëve vendas për ujin dhe pakësimin e përdorimit të tij për vaditjen, kullotjen dhe rritjen e barit me të cilën ata kanë lidhur jetesën e tyre. Këto hapa në të vërtetë, bien ndesh me kërkesat mjedisore dhe sociale të BERZH-it. Banorët u ankuan për pakësimin e burimeve ujore, tek autoritetet vendore, ministritë e linjës dhe Avokati i Popullit, duke kërkuar që punimet për ndërtimin e HEC-it të ndaleshin. Si përgjigje banorëve iu tha se punimet kishin avancuar në një fazë të tillë sa ishte e pamundur ndryshimi i projektit. Në vitin 2014, banorët nisën një sërë protestash që përshkallëzuan në rrethimin e kampit të ndërtimit dhe arrestimin e protestuesve nga policia. Në ditën e tejkalimit të kostove dhe vonesave të projektit, investitori, kërkoi mënyra të tjera për të angazhuar banorët vendas. Megjithatë, mungesa e konsultimit të hershëm e ka çënuar procesin e besimit mes kompanisë dhe banorëve të prekur.</p>
<b>Të dhëna kryesore</b>	<p><b>Teodor 2003 shpk</b> Kapaciteti i instaluar 8,385 Kwh, prodhimi i parashikuar 56,935,350 kwh. Sasia e ujit që do shfrytëzohet është 1m<sup>3</sup>/s. Projekti u miratua me VKM nr.556, datë 1.08.2003 dhe u ndryshua me VKM nr.123, datë 14.03.2007 i cili ndryshoi nga 6 HEC-e në 1 HEC.</p>
<b>Burimi i konfliktit</b>	<p>Ndarja e ujit – niveli i 1-rë i konfliktit Ndikimi mjedisor – niveli i 2-të i konfliktit</p>
<b>Detaje të projektit dhe aktorët Zona e projektit</b>	<p>HEC Ternova, është në pronësi të Teodor 2003 shpk (me pronar Faik Teodori (30%), Shefikat Ngjela (35%) dhe Albania Hydro Investment Holding (30%) dhe TEODOR 5%. Projekti ndodhet në fshatin Valikardhë në Zerqan Bulqizë.</p>
<b>Niveli i investimit Konflikti dhe mobilizimi</b>	<p>18.500.000 EUR Protestë rruge, bllokim rruge, konfrontim me policinë, peticion qeverisë, persona të arrestuar.</p>
<b>Ndikimi i konfliktit</b>	<p><b>Dokumentuar</b> Ndikimi mjedisor: ndarja e ujit, humbja e peizazhit, devijim i ujit të Liqenit të Zi.</p>
<b>Rezultati i konfliktit</b>	<p><b>Potencial</b> Mungesa e vaditjes ndikimi social-ekonomik. Ndërtuar Asnjë ndryshim institucional I pa suksesshëm pasi projekti u ndërtua</p>
<b>Burime dhe materiale/Referenca</b>	<ul style="list-style-type: none"><li>- <a href="http://balkanrivers.net">http://balkanrivers.net</a></li><li>- <a href="http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/kunder-hec-banoret-sulmojne-kompanine-200-mije-euro-dem-219098.html">http://shqiptarja.com/aktualitet/2731/kunder-hec-banoret-sulmojne-kompanine-200-mije-euro-dem-219098.html</a></li><li>- NIPT K42301006L, Ekstrakt historik nga Qendra e Regjistrimit të Biznesit.</li></ul>